

VENDIM
Nr. 99, datë 7.11.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2015 dhe relacionin e grupit të punës,

konstatoi se:

Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga KESH sh.a.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës të prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2015.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti